



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA – SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

14-05-2025

REPUBLIKA E KOSOVËS		REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA – SUHAREKË		OPSTINE SUVA REKA	
MARKE NË DORËZIM - PRILAVO - RECEIVED			
Njësia e g.	Numri	Shtesa	Vlera
Org. Unit	Number	Appendix	Value
08	016	27829	1

DREJTORIA PËR BUJQËSI, ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI

Datë; 14.05.2025

Duke ju referuar nenit 3 të vendimit të datës 05.05.2025 me nr të protokollit 08 – Nr-016-26209, Drejtori i DBZHRP bënë këtë:

Rishpall

THIRRJE PËR APLIKIM

Njoftohën fermerët e komunës së Suharekës se Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë për vitin 2025, ka paraparë që të bëjë ndërtimin e **SERAVE** me participim për kultivuesit e perimeve.

Llojet e sipërfaqeve për aplikim; 100 m², 200 m² dhe 500 m².

Të drejtën për aplikim e kanë të gjithë fermerët e komunës së Suharekës që i përmbushin kushtet dhe kriteret e parapara si:

- Të jetë i gatshëm të kryej participimin prej 10 %.
- Të prezentojë certifikatë të pronës së paku 0.50 ha për fermeret që aplikojnë për Seren me sipërfaqe prej **500 m²**.
- Të prezentojë certifikatë të pronës së paku 0.30 ha për fermeret që aplikojnë për Seren me sipërfaqe prej **200 m²**.
- Të prezentojë certifikatë të pronës së paku 0.20 ha për fermeret që aplikojnë për Seren me sipërfaqe prej **100 m²**.
- Certifikata e pronës (nëse prona nuk është në emër të tij, aplikuesit i pranohet aplikacioni nëse është në bashkëpronësi me pronarin, në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut (p.sh: gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, mbesat në bazë të ligjit në fuqi).

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës.
- Çertifikata e pronës.
- Për aplikuesit të cilët nuk e kanë pronën në emër të tyre, duhet të prezantojnë certifikatën e bashkësisë familjare për ata që janë në bashkësi familjare.
- Për aplikuesit që nuk janë bashkësi familjare duhet të prezantojnë certifikatën e lindjes, certifikatën e martesës, apo nëse nuk është në jetë pronari i pronës, certifikatën e vdekjes, për të dëshmuar afërsinë e tij familjare me pronarin e tokës dhe aplikuesin.

Participimi i fermerëve përfitues të Serave do të bëhet duke bërë pagesën e 10 % të vlerës së përgjithshme të serës në llogari të Komunës së Suharekës, ndërsa pjesa tjetër e vlerës apo **90%** nga shuma e përgjithshme financohet nga Komuna e Suharekës.

Informatat dhe data e aplikimit

Aplikacioni merret tek zyra pritese Nr.1, poashtu edhe dorzimi i aplikacionit behët tek zyra pritese Nr. 1 përmes protokollit zyrtar për Drejtorinë e Bujqësisë.

Afati i aplikimit fillon prej datës 14.05.2025 deri me datën 26.05.2025.

Drejtor i DBZHRP

Ardian Kotorri

